



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 133, dt. 16.07.2015**

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e dates 16.07.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit të ujësjellësit të ri të Durrësit dhe projektit të ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve Ura e Dajlanit – Plepa, Durrës.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**